



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
DREJTORIA E MONITORIMIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË SHOQËRIVE UJËSJELLËS KANALIZIME

Nr. 351 prot.

Tiranë, më 31.01.2019

Lënda: Për nënshkrimin e kontratës së performancës.

BASHKISË Shkodër

Në mbështetje të reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime, prioriteti i qeverisë shqiptare, bashkëlidhur po ju dërgojmë kontratën e performancës për vitin 2019, formati i të cilës është miratuar me Udhëzimin nr.138, datë 30.01.2018 "Për miratimin e treguesve dhe kriterëve të përfshira në kontratën e performancës (Model Tip) për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve".

Dy nga kopjet, të nënshkuara dhe të protokolluara nga ana juaj, të dërgohen në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, brenda datës 07.02.2019.

Faleminderit për bashkëpunimin

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Arben Skënderi

VENDIME, UDHËZIME, SHKRESA, KERKESA
NR. 1718 DATE 4.02.19
BERGJAR NGA:
LËNDA:

PËRQISJA E TITULLARIT:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4199 Prot

Shkodër, më 15.03.2019

Lënda: Dërgim i kontratës së performancës.

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCISË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
DREJTORISË SË MONITORIMIT
SEKTORIT TË MONITORIMIT TË SHOQËRIVE UJËSJELLËS KANALIZIME

Adresa: Rruga "Sami Frashëri" Nr 4 Tiranë

Të nderuar!

Bashkëlidhë gjeni 2 kopje të kontratës së performancës të lidhur mes Agjencisë Kombëtare Të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Bashkisë Shkodër.



NDËRMJET:

KONTRATË PERFORMANCE

AGJENCISË KOMBËTARE TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE - BASHKISË SHKODËR

1. PALET BIEN DAKORT SI MË POSHTË:


Kjo Kontratë Performance nënshkruhet sot më datë _____ midis Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), përfaqësuar nga Z. Alqi Bllako me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, me adresë Rruga "Sami Frashëri", nr. 4, Tiranë, dhe Bashkisë Shkodër, me adresë Rruga 13 Dhjetori Nr.1 Shkodër, përfaqësuar nga Kryetarja e saj, zonja Voltana Ademi.

2. BAZA LIGJORE DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- 2.1. Kjo Kontratë, bazohet në ligjin nr. 99/2018 "për buxhetin e vitit 2019", dhe në zbatim të ligjit nr. 139 / 2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" dhe VKM-së Nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve".
- 2.2. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë kohore prej 1 viti që nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët e marrëveshjes.
- 2.3. Kjo kontratë ndërtohet duke mbajtur parasysh objektivat strategjike të qeverisë për sektorin si dhe ato të Bashkisë përkatëse për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, të shprehura në Planin e Biznesit të miratuar / që do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme/Këshilli / Këshillat Bashkiake.

3. QËLLIMI I KONTRATËS SË PERFORMANCËS

- 3.1. Qëllimi i kësaj kontrate, është rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve dhe e përmirësimit të performancës së operatorit të shërbimit të UK brenda juridiksionit të bashkisë/bashkive, në funksion të arritjes së objektivave strategjike, për plotësimin e kërkesave në rritje të të gjithë popullsisë së vendit, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.
- 3.2. Në kushtet e reja të krijuara mbas reformës territoriale dhe administrative dhe për rrjedhojë me zgjerimin e zonës së shërbimit dhe riorganizimit të shoqërive UK, është qëllimi i AKUM që të lehtësojë, asistojë dhe thellojë bashkëpunimin mes Bashkisë dhe shoqërisë së UK për të përmbushur misionin e përbashkët për këto shërbime.
- 3.3. Kontrata ka gjithashtu për qëllim të forcojë shoqërinë UK për të operuar si një entitet vetadministrues, sipas statusit të saj ligjor, nën kontrollin e Këshillit Administrativ të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.



3.4. Palët në këtë kontratë kanë për qëllim që të bashkëpunojnë, për të arritur indikatorët e performancës sic janë përcaktuar në Shtojcat 3,4 dhe 5 që si më poshtë shoqërojnë këtë marrëveshje.


4. AKUM, NË FUNKSION TË PËRMBUSHJES SË MISIONIT DHE DETYRAVE QË KA, MERR PËRSIPËR:

- 4.1 AKUM do të koordinojë dhe monitorojë të gjitha aktivitetet sektoriale për sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror dhe vendor, që të ndihmojë në arritjen e objektivave për të cilat është rënë dakord midis palëve.
- 4.2 Gjatë planifikimit të nevojave për investime të financuara nga buxheti i shtetit, do të kujdeset që këto të fundit të jenë në përputhje me nevojat sipas objektivave të bashkisë dhe planit të biznesit të shoqërisë UK.
- 4.3 Asiston bashkinë/sh.a UK për të hartuar projekt propozimet për investime të financuara nga buxheti i shtetit apo burime të tjera si dhe monitoron implementimin e tyre. Asiston bashkinë/sh.a UK, sipas kërkesës, për të hartuar projekt propozime për aplikim për kreditim nga bankat e nivelit të dytë, sipas legjislacionit në fuqi si dhe monitoron implementimin e tyre.
- 4.4 Miraton të gjithë projektet e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Impianteve të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, të financuara nga buxheti i shtetit, apo institucione financiare vendore dhe ndërkombëtare, konsulton dhe siguron asistencë teknike kur kjo kërkohet me shkrim ose komunikim elektronik, për çdo projekt që financohet nga buxheti i bashkisë, buxheti i sh.a UK, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit dhe zbatimit.
- 4.5 Ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve në sektor, pavarësisht burimit të financimit, në mënyrë që të sigurohet që projektet të arrijnë rezultatin e projektuar.
- 4.6 Shpërndan fondin e subvencioneve dhe fondin e financimit për performancë, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe një metodologji transparente me qëllim përmirësimin e performancës në shërbimin e UK.
- 4.7 Përgatit dhe vë në dispozicion manuale të operimit, si dhe udhëzime për hedhjen e të dhënave në programet dhe platformat e monitorimit, si dhe asiston personelin përkatës të ngarkuar nga bashkia/sh.a UK, në rastet kur kjo asistencë kërkohet nga bashkia/shoqëria UK me shkrim ose mjete elektronike për të përmbushur këtë detyrim.
- 4.8 Vë në dispozicion të shoqërisë UK, manualin/instrumentin për hartimin e planit të biznesit, si dhe asiston/trajnon personelin përkatës të ngarkuar nga Bashkia/shoqëria UK për të hartuar planin e biznesit, në rastet kur kjo asistencë kërkohet nga Bashkia/shoqëria UK.
- 4.9 Monitoron treguesit e performancës për të cilat është rënë dakord mes palëve.
- 4.10 Njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë dhe Ministrin përgjegjës për infrastrukturën, çdo 6 muaj për ecurinë e treguesve të performancës, pjesë e kësaj marrëveshjeje.
- 4.11 Merr në konsideratë gjatë planifikimit të nevojave për trajnim, kërkesat nga bashkia / sh.a UK përkatëse.
- 4.12 Organizon një grup pune të kualifikuar i cili ka si funksion të asistojë bashkinë dhe operatorët që të përmbushin objektivat dhe të arrijnë treguesit si në këtë marrëveshjeje.



5. BASHKIA, NË PËRMBUSHJEN E FUNKSIONIT TË SAJ LIGJOR PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE UK MERR PËRSIPËR:

- 5.1 Bashkia ka detyrimin që në ushtrimin e funksioneve të veta, të garantojë zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për këtë sektor.
- 5.2 Brenda zonës së juridiksionit të saj, Bashkia është përgjegjëse për dhënien e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet shoqërisë aksionere apo çdo operatori tjetër në pronësi të saj. Zona e juridiksionit të Bashkisë dhe zona e shërbimit të sh.a. UK-së përputhen dhe specifikohen përkatësisht në shtojcën 2 të kësaj marrëveshje.
- 5.3 Bashëpunon dhe kujdeset që fondet e financuara nga AKUM për qëllimin e përmirësimit të performancës, të përdoren me eficiencë nga operatori / shoqëria për arritjen e qëllimit të kësaj marrëveshje.
- 5.4 Miraton Planin e Biznesit 5 vjeçar të sh.a UK, ku janë reflektuar objektivat dhe treguesit e performancës për çdo vit dhe nevojat për mbështetje financiare.
- 5.5 Me kërkesën e saj, i paraqet AKUM nevojat për investime dhe mbështetje financiare për përmbushjen e objektivave dhe të treguesëve të performancës sipas Biznes Planit.
- 5.6 Me kërkesën e saj i paraqet për miratim AKUM, projektet teknike të cilat kanë si synim përmbushjen e objektivave dhe treguesve të përformancës sipas Planit të Biznesit;
- 5.7 Rishikon dhe miraton çdo vit Planin e Biznesit, duke patur parasysh reflektimin e treguesve të rëna dakort në marrëveshjen me AKUM.
- 5.8 Paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën (MIE), AKUM-së dhe Entit Rregullator të Ujit (ERRU), jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të vitit financiar, Planin e Biznesit të rishikuar.
- 5.9 Merr përsipër që nëpërmjet mekanizmave të kontrollit që disponon, të garantojë që shoqëria nuk do të devijojë nga Plani i Biznesit.
- 5.10 Planifikon investime në sektorin UK dhe ITUN, brenda kapaciteteve të veta buxhetore, në përputhje me Planin e Biznesit të miratuar.
- 5.11 Mbështet sh.a UK në procesin e faturimit dhe në mbledhjen e të ardhurave dhe siguron që të gjitha institucionet që operojnë me buxhetin e saj apo varen prej saj, të paguajnë në kohë faturat e tyre të shërbimit.



6. NDRYSHIMET E KONTRATËS

6.1 Ndryshimet në këtë kontratë bëhen me pëlqimin e të dy palëve dhe janë të vlefshme, pasi bëhen me shkrim dhe firmosen prej tyre.

7. PROCEDURAT E ZGJIDHJES SË MOSMARRËVESHJEVE

7.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate janë subjekt negociimi dhe zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

8. DISPOZITË PËRFUNDIMTARE

8.1 Kjo kontratë hartohet në tre origjinale, një për secilën palë, përfshirë, AKUM dhe Bashkinë.

8.2 Një origjinal i kësaj marrëveshje depozitohet në ERRU.

**AGJENCIA KOMBËTARE E
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
DHE INFRASTRUKTURËS
SË MBETJEVE**

BASHKIA SHKODËR

Alqi Blako
DRETOR I PËRGJITHSHËM



Voltana Ademi
KRYETARË E BASHKISË



U.K.Sh

Morke Dajç
Velbona Pejo
Pejo

Shtojca 1: Fondi I Bashkisë Shkodër/SHA Ujësjetës Kanalizime Shkodër

Emërtimi	Shuma (Lekë)
Subvencione për performancë	Pas daljes së rezultatve të vitit 2018
Subvencione për operim	Pas daljes së rezultatve të vitit 2018
Investime me fondet nga buxheti i Bashkisë Shkodër viti 2019	12 € / lidhje
Shuma Lekë	

Shtojca 2: Zona e Shërbimit të Shoqërisë SHA Ujësjetllës Kanalizime Shkodër

Bashkia	Qyteti/Njesia Administrative/Fshati	Popullsia e sherbyer FU ²	Popullsia Totale ³
Shkodër	Shkodër	109,695	200,674
	Ana e Malit		
	Bërdicë		
	Dajç		
	Guri I Zi		
	Postribë		
	Pult		
	Rrethinat		
	Shalë		
	Shosh		
	Velipojë		
	Total	109,695	200,674

² Te dhena te raportuara prane Njesise se Monitorimit; AKUM 6 mujore 2018

³ Te dhena te raportuara prane Njesise se Monitorimit; AKUM 6 mujore 2018

Shtojca 3: INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË AKSIONIT GJATË VITIT 2019

SHA Ujësjetës Kanalizime Shkodër

1. Numri i lidhjeve, duke e krahasuar me numrin e njësisve të adresave nga projekti i adresarit, do të duhet të jetë në masën 32.500 lidhje. (shkalla e realizimit deri me 30.06.2018 është 56%).
2. Rritja e shumës monetare të faturimeve korrente për vitin 2019 me të pakten 10%.
3. Arkëtimi i të gjithë faturave korrente të 2019, në masën mbi 78%.
4. Vendosja e ujëmatësave tek çdo konsumator (në 63% të konsumatorëve me kontratë) (grup abonentësh dhe lidhja e një kontrate kolektive, ose kontratave fikse me konsumatorët për çezmat e përbashkëta).
5. Vendosja e ujëmatësave funksional dhe kalibruar për matjen e sasive të ujit që futet në rrjet, në çdo burim dhe pus në masën 50%.
6. Te mbahet i pa ndryshuar niveli aktual i kostos direkte operative në masën e vitit 2018.
7. Arkëtimi i detyrimeve të prapambetura (si referencë 31.12.2018) në masën të paktën 7% të totalit të tyre.
8. Reduktimi i ujit pa të ardhura, në fund të vitit 2019 në masën 3%, në krahasim me fundin e vitit 2018.
9. Rikuperimi i kostos totale të operimit me arketimet në masën 70%.
10. Investime me fondet nga buxheti i Bashkive respektive në masën jo më pak se 12 €/lidhje.
11. Lidhja e aktmarrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që shoqëria i ka të tretëve duke filluar shlyerjen e detyrimeve me këste.
12. Anketim, kontroll dhe inspektim për të identifikuar përdorimin e paautorizuar në masën 90%.
13. Shkeputja e lidhjeve të paautorizuara në masën 90%.
14. Inspektimi i të gjithë matësve të konsumatorëve për të identifikuar matesat jofunksional. (numri i matësve do të përcaktohet gjatë negociatave me bashkinë dhe shoqërinë).
15. Zëvendësimi i matësve egzistues të konsumit jo-funksional në masën 50%.